

PRANIM NË SPITAL ME URDHËR TË SPITALIT PA FRENIME

(Paragrafi 37 i Aktit për Shëndetin Mendor 1983)

| | |
|--|--|
| 1. Emri i pacientit | |
| 2. Emri i personit përgjegjës për kujdesin tuaj (“klinikisti përgjegjës”) | |
| 3. Emri i spitalit dhe pavijonit | |
| 4. Data e urdhërit të spitalit | |

Përse jam në spital?

Ju mbaheni në këtë spital sipas urdhërit të Gjykatës. Gjykata thotë se ju duhet të mbaheni këtu sipas paragrafit 37 të Aktit për Shëndetin Mendor 1983.

Kjo quhet “urdhër spitali”. Kjo do të thotë se dy mjekë e kanë njoftuar Gjykatën se ju keni çrregullim mendor dhe se ju duhet të qëndroni ne spital.

Sa kohë do të qëndroj këtu?

Fillimisht , ju mund të mbaheni këtu deri në gjashtë në mënyrë që të merrni mjekim të nevojshëm.

Gjatë kësaj kohe ju nuk duhet të dilni nga spitalin, përveç nëse personi përgjegjës për kujdesin tuaj (klinikisti i juaj përgjegjës) ju thotë se mund të dilni. Nëse provoni të dilni nga spitali stafi mund t’ju ndaloj, dhe nëse dilni ata mund t’ju kthejnë mbrapsht.

Çfarë ndodhë më tutje?

Klinikisti i juaj përgjegjës ju tregon nëse mendon se ju jeni në gjendje të mire që të dilni nga spitali. Nëse klinikisti i juaj përgjegjës mendon se ju duhet të qëndroni në spital më shumë se gjashtë muaj, ai mund ta përtërijë qëndrimin tuaj edhe për gjashtë muaj të tjerë,

dhe pastaj edhe për nga një viti. Klinikisti I juaj përgjegjës do të bisedoj me ju lidhur me këtë nga fundi i çdo periudhe.

A mund të apeloj?

Yes. Ju mund të kërkonit nga Gjykata që t'ua shqyrtoj çështjen përsëri. Nëse dvshironi ta bëni këtë ju duhet ta bëni shpejtë dhe të kërkonit ndihmë nga një avokat. Pyetni stafin e spitalit lidhur me këtë dhe ata do t'ju jepin një fletëpalosje tjetër.

Për ta bërë këtë ju duhet të kërkonit nga Drejtuesit e Spitalit t'ju lejnë të dilni nga spitali. Këtë mund ta bëni në çdo kohë. Drejtuesit e Spitalit janë komision i veçantë i hapur brenda spitalit për të vendosur nëse njerëzit duhet të mbahen akoma në spital. Ata do të dëshirojnë të bisedojnë me ju para se të vendosin nëse ju lejnë të dilni nga spitali. Nëse dëshironi ta bëni këtë, ju mund t'ju shkru atyre në adresën:

Ose mund të pyetni një anëtar të stafit për t'ju ndihmuar t'i kontaktoni Drejtuesit e Spitalit.

Pas caktimit të urdhërit të spitalit për gjashtë muaj, ju dhe anëtari më i afërm familjar mund të kërkonit nga Tribunali që t'ju thotë se ju nuk duhet mbaheni në spital. Kjo fletëpalosje ju shpjegon më poshtë se cilët janë anëtarët më të afërm të familjes tuaj.

Ç'është Tribunali dhe çfarë ndodhë?

Tribunali është një kuadro e pavarur e cila mund të vendos nëse ju akoma keni nevojë për kujdestar. Ky kuadër do të mbajë një mbledhje me ju dhe me stafin që ju njeh juve. Kjo mbledhje quhet "seancë". Nëse doni ju mund të kërkonit nga një person të vjen në seancë për t'ju ndihmuar. Para seancës, anëtarët e Tribunalit do të lexojnë raportin lidhur me ju dhe kujdestarinë tuaj. Njëri nga anëtarët e Tribunalit do të vijë të flas me ju.

Kur mund të aplikoj tek Tribunali?

Pas gjashtë muajve të lëshimit të urdhërit të spitalit, ju dhe një anëtar i afërm i familjes tuaj mund të aplikoni tek Tribunali një herë në gjashtë muajt e ardhshëm. Që të dy mund të aplikoni një herë për çdo vit që mbaheni në spital.

Nëse doni të aplikoni tek Tribunali, ju mund t'i shkruani në adresën:

The Tribunals Service(Shërbimit i Tribunalit)

PO BOX 8793
5th Floor
Leicester
LE1 8BN

Tel. 0845 2232022

Ju mund të kërkoni nga avokati t'i shkruaj Tribunalit për ju dhe t'ju ndihmoj në seancë. Autoriteti i shërbimeve sociale dhe shoqata e drejtësisë kanë një listë të avokatëve të specializuar për këtë çështje. Ju nuk duhet të paguani avokatin për këtë ndihmë. Ky shërbim është falas në bazë të skemës për Ndihmë Ligjore.

Çfarë mjekimi do t'më jepet?

Klinicisti i juaj përgjegjës dhe një anëtar i stafit do të bisedojnë me ju lidhur me ndonjë mjekim të nevojshëm sipas mendimit të tyre. Në të shumtën e rasteve ju duhet të pranoni mendimin e tyre.

Pas tre muajve ekzistojnë ka rregulla tjera të veçanata lidhur me medikamentet ose ilaçet që ju jepen për çrregullimin tuaj mendor. Nëse nuk i merrni medikamentet ose ilaçet, ose jeni shumë të sëmurë për ti marrë ato, një mjek i cili nuk është nga ky spital do t'ju vizitoj. Ky mjek i pavarur do të bisedoj me ju dhe stafin e spitalit që ju njeh juve. Mjeku i pavarur do të vendos se çfarë medikamente ose ilaçe do t'ju jepen. Këto janë të vetmet medikamente dhe ilaçe që mund t'ju jepen pa pëlqimin tuaj, përveç nëse është rast urgjent.

Mjeku i pavarur quhet SOAD (Mjek i caktuar për një mendim tjetër) dhe është i caktuar nga një Komision i pavarur i cili e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor.

Ka rregulla të ndryshme për disa mjekime të veçanta, siç është terapia elektro-konvulsive (ECT). Nëse stafi mendon se ju keni nevojë për një nga këto mjekime të veçanta, do t'ju shpjegohen rregullat dhe do t'ju jepet një fletëpalosje tjetër.

Njoftimi i anëtarit më të afërm familjar

Një kopje e kësaj fletëpalosje do ti jepet një personi të cilin Akti i Shëndetit Mendor e konsideron si më të afërmin e familjes tuaj.

Është një listë e njerëzve në Aktin e Shëndetit Mendor që konsiderohen si anëtar të familjes suaj. Zakonisht, personi që është në krye të listës është anëtari më i afërt familjar. autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë dhe se çfarë të drejtash ka me i afërmi familjar tuaj në lidhje me kujdesin dhe mjekimin.

Ne jemi njoftuar se në rastin tuaj, anëtari më i afërt familjar është:

Nëse ju nuk dëshironi që ky person të marrë një kopje të fletëpalosjes, ju lutem tregoni infermierit tuaj ose një anëtar të stafit.

Ndërrimi i anëtarit më të afërm familjar

Nëse mendon se ky person nuk është i përshtatshëm të konsiderohet më i afërmi i familjes tuaj, ju mund të aplikoni tek Gjykata e Qarkut për të konsideruar një person tjetër si më të afërmin tuaj familjar. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë.

Letrat e juaja

Të gjitha letrat e marruara gjatë qëndrimit tuaj në spital do t'ju dorzohen juve. Ju mund t'ju dërgoni letër çdonjërit, përveç ndonjërit që ka pohuar se nuk dëshiron të marrë letra nga ju. Letrat dërguar këtyre personave mund të ndalohen nga stafi i spitalit.

Kodi Praktik

Kodi Praktik është ai që jep këshilla lidhur me Aktin e Shëndetit Mendor njerëzve të përfshirë në kujdesin tuaj. Ata duhet të marrin parasysh se çfarë thotë Kodi kur të marrin vendim lidhur me kujdesin tuaj. Nëse doni , ju mund të kërkonit të shihni një kopje të Kodit.

Si të ankohem?

Nëse doni të ankoheni lidhur me ndonjë pakënaqësi që ka të bëjë me kujdesin dhe mjekimin tuaj në spital, ju lutem bisedoni me një anëtar të stafit. Ata mund të rregullojnë këtë çështje. Ata poashtu mund t'ju jepen informacion lidhur me procedurën e ankimit të spitalit, të cilën mund të përdorni për të zgjidhur pakënaqësinë tuaj nëpërmjet të quajturit vendim lokal. Ata poashtu mund t'ju tregojnë për persona të tjerë që mund t'ju ndihmojnë për t'u ankuar.

Ju poashtu mund të ankoheni tek një Komision i pavarur. Komisioni i pavarur e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor, për të siguruar përdorim të drejtë dhe kujdes të duhur ndaj pacientëve gjatë qëndrimit të tyre në spital. Stafi i spitalit mund t'ju jep një fletëpalosje e cila shpjegon se si të kontaktoni me Komisionin.

Ndihmë dhe informacion të mëtejshëm

Nëse ka diçka që nuk kuptoni lidhur me kujdesin dhe mjekimin, një anëtar i stafit do të përpiqet t'ju ndihmoj. Ju lutem kërkoni nga një anëtar t'ju shpjegoj nëse ka diçka në këtë fletëpalosje që nuk kuptoni, ose nëse keni ndonjë pyetje tjetër që nuk iu ka përgjegjur fletëpalosja.

Ju lutem kërkoni një kopje të kësaj fletëpalosje nëse i duhet edhe dikujt tjetër.